



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1015/ 5 prot.

Datë 09.06.2022

V E N D I M

Nr. 549 /2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.06.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-24676-04-11-2022 me objekt “Blerje kancelarie për Bashkinë Fushë-Arrëz”, me fond limit 1,404,780.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 27.04.2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Fushë-Arrëz.

Ankimues: “Infosoft Office” SHPK
Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Kashar, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Fushë- Arrëz
Fushë-Arrëz

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.04.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-24676-04-11-2022 me objekt “Blerje kancelarie për Bashkinë Fushë-Arrëz”, me fond limit 1,404,780.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 27.04.2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Fushë-Arrëz.

II.2. Në datën 27.04.2022, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 05.05.2022 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- “Librari Dyrrahu” SHPK	949 494.00 lekë	skualifikuar
- “Infosoft Office” SHPK	912 111.00 lekë	skualifikuar
- Adenis Kastrati p.f	1,188.900.00 lekë	kualifikuar
- “Tim” SHPK	1 399 870.00 lekë	skualifikuar
- “Marketing & Distribution” SHPK	1,399,915.80 lekë	kualifikuar
- Sofia Myftari p.f	1,357.844.00 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 09.05.2022, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike “Njoftimi i Fituesit’.

II.5. Në datën 12.05.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2022/2189 dhe me nr. 1015 prot., datë 12.05.2022 e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi duke argumentuar: *“Bazuar në arsyet e skualifikimit të ofertës sonë, gjykojmë dhe argumentojmë si më poshtë:*

Fillimisht ju lutemi te beni ndryshimin dhe ndarjen midis taksave si tarifa vendore, taksat si Detyrime fiskale dhe kontributet e sigurimeve shoqerore, pasi jane koncepte te ndryshme dhe te pavaruara nga njera tjetra.

Mbi taksat si tarifa vendore, ju sqarojme se:

Per pretendimin e AK mbi mosparaqitjen e dokumentit per te vertetuar se jane paguar taksat; Dokumenti i cili verteton se taksat jane paguar eshte ngarkuar ne SPE sipas kerkeses te kryer ne DST ne kriteret e vecanta; “kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2.2”. Ky dokument provon qe jane likuiduar detyrimet e taksave vendore te parashikuara sipas Ligjit Nr.1632 date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore, me ndryshimet perkatese” si dhe Vendimit te Keshillit Bashkiak Nr.158, date 26.12.2019 “Per sistemin e taksave dhe tarifave vendore ne qytetin e Tiranës. Per me teper pavaresisht se eshte kerkuar vetem per vitin 2021, ne kemi ngarkuar dhe dokumentin per vitin 2022, per te provuar keshtu se shoqeria jone nuk ka detyrime te palikuiduara dhe vepron konform ligjeve dhe rregullave. Pretendimi i AK nuk qendron.

Mbi kontributet e sigurimeve shoqerore, ju sqarojme se:

Per pretendimin e AK mbi mosparaqitjen e dokumentit per te vertetuar se jane paguar kontributet e sigurimeve shoqerore, perkatesisht pika 1 dh e “kritereteve te pergjithshme te perzgjedhjes/kualifikimit”. Pika 1 dh eshte nje nga elementet e formularit te vetdeklarimit. Me ligjin e ri Nr.162/2020,OE nuk ka detyrim ligjor ta paraqesi kete dokument ne fazen e ofertimit. Ju sjellim ne vemendje Nenin 26, pika 6 te VKM Nr.285, date 19.05.2021, ku parashikohet se:

“Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike”. Sic e ka parashikuar ligjvenesi, ky eshte nje nga dokumentet te cilat dorezohen perpara se te lidhet kontrata, me ardhjen e njoftimit paraprak te fituesit si dhe me kerkese te AK. Pra dorezimi i ketij dokumenti do te behej me ardhjen e njoftimit paraprak te fituesit, se bashku me te githe dokumentet e tjera te deklaruar ne shtojcen 8. Nuk kuptojme perse AK ka mbajtur 2 standarte mbi kriteret e pergjithshme, dhe kerkon qe te dorezohen qe ne fazen ofertuese vetem 2 nga 12 dokumente provuese te vetdeklarimit. Gjithashtu kujtojme AK ne cdo rast mund te kerkoje sqarime dhe dokumente mbeshtese mbi cdo paqartesi ose pretendim

qe ka ne lidhje me deklarimet qe ben OE gjate nje procedure prokurimi. Baza ligjore qe e mbeshtet kete argumentim eshte Neni 26 pika 7 VKM Nr.285, date 19.05.2021:

“Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose ti kërkojë Operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime”.

AK ne asnje moment nuk ka tentuar te komunikojte me shoqerine tone mbi keto paqartesi ne kundeshitim te plote me ligjin. Per me teper ka vendosur te na skualifikoje dhe ka vijuar me kualifikimin e nje oferte rreth 20% me te larte se oferta jone, duke shkaktuar keshtu nje dem ekonomik ne buxhetin e shtetit. Keshtu qe as ky pretendim i ngritur prej tij nuk qendron.

? Mbi taksen si detyrim fiskal, ju sqarojme se:

“Infosoft Office” sh.p.k me NIPT J62424002Q, me administrator Z. Gëzim Dobi nuk ka detyrime tatimore në Tatimin mbi Vleren e Shtuar, mbi Fitimin, Tatim mbi të Ardhurat Personale. AK permend si arsye skualifikimi “se subjekti ne fjale rezulton me gjobe dhe vendimi i gjykates i vitit 2019 nuk verteton lidhjen me detyrimin ne fjale”. Ne SPE kemi dorezuar 4 dokumente qe ne fazen ofertuese per t’ju vene ne dijeni mbi situaten e detyrimeve tatimore, konform ligjit. (i gjeni te rendituara dhe me shpjegimet perkatese si me poshte)

1. Vertetim i leshuar nga Drejtoria e Tatimpagueseve te medhenj, Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, Nr.392 Prot, date 12.04.2022 ku shprehimisht vertetohet se:

“Infosoft Office nuk ka detyrime tatimore ne Tatimin mbi vlerën e Shtuar mbi fitimin, kontributeve te sigurimeve shoqerore, shendetesore, tatim mbi te ardhurat personale por ka detyrim (gjobe) ne Tatimin ne burim ne Shumen 812.500 leke, per te cilat ndodhet ne proces ankimimi administrativ.”

2. Vendim Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane, Nr.4488 Vendimi, date 30.12.2019, ku na eshte dhene e drejte pjesisht.

Çeshtja ne kete moment eshte ne Gjykatën Administrative te Apelit. (bashkelidhur dok).

Duket qarte qe flitet per te njejten shume dhe te njejten periudhe. Gjithsesi, nga vertetimi i Drejtorise se Tatimpaguesve te Mëdhenj, duket qarte qe detyrimi yne eshte nje “gjobe” e cila ndodhet ne proces ankimimi.

Lidhur me suate te tilla, jane shprehur qarte shume institucione. Me i rendesishmi eshte : Vendimi Unifikues Nr.4, datë 30.05.2011 i Gjykatës së Lartë i cili shprehet se: “Me “detyrim tatimor”, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 6/3 nënkupton “tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”.

Dallohet qartësia në ligj që, për t’u marrë në shqyrtim ankimi, detyrimisht duhet që të parapaguhet, sipas aktit administrativ Njoftim-vlerësimit, detyrimi tatimor, i cili duhet të ketë të përfshirë tatimin dhe kamatëvonesat. Gjobat, megjithëse konsiderohen sipas nenit të cituar, si pjesë e detyrimit tatimor, nuk përfshihen, si pjesë e parapagimit të detyrimit, si një kusht i domosdoshëm për të marrë në shqyrtim ankimin administrativ”. Bazuar dhe ne zbatim te ketij vendimi unifikues te Gjykates se Larte, Komisioni i Prokurimit Publik, ka marre disa vendime , psh:

a. Vendim KPP Nr.651/2017, i cili ka vendosur se:

“Shuma e detyrimit për t’u paguar përfshin vetëm shumën e tatimit dhe interesin, nëse ka, në aktin administrativ që ankimohet, që është i pagueshëm në momentin e ankimit, duke përjashtuar gjobat e përfshira në aktin administrativ objekt ankimi”. Komisioni i

Prokurimit Publik gjykon se, skualifikimi prej autoritetit kontraktor i një operatori ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi me argumentin se “ka detyrime tatimore të pashlyera”, kur me këto të fundit nënkuptohen gjopa të cilat janë në proces ankimimi, nuk është në përputhje me frymën e legjislacionit për prokurimin publik.”

b. Vendim KPP Nr.321/2020, I cili ka vendosur se:

“Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në ato raste kur nga operatori pjesëmarrës në procedurën e prokurimit është paguar tatimi përkatës dhe interesi, ndërkohë që gjopa është në proces ankimimi, nuk mund të ngrihet si pretendim dhe të shërbej si arsye skualifikimi.”

Keto dokumente janë ngarkuara te gjitha ne SPE.

Gjithashtu, Neni Nr.76 pika 2 a, te LPP Nr.162/2020, parashikon se:

“Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;”

Per sa thame me lart, vendimet dhe vertetimet perkatese jane ngarkuar ne SPE qe ne fazen e ofertimit, per te treguar transparencen dhe faktin se gjopa nuk eshte detyrim tatimor per t'u parapaguar, persa kohe ajo eshte ne proces ankimimi. AK nuk ka marre ne konsiderate asnje nga keto dokumente te ngarkuara ne sistem. Qartesisht qe ky pretendim I AK per skualifikimin e shoqerise tone nuk qendron, dhe eshte dukshem diskriminues.

Se fundmi, mbi pretendimin e AK, se:

“Mungojne dokumentet qe ka kryer sherbime te ngjashme, kerkuar ne DST, pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2.3.1, ne lidhje me sherbime te ngjashme te realizuara, vertetimi i realizmit me sukses te kontrates nuk ka numer protokollit te rregullt, por eshte vertetim i marre me numer protokollit ekstra, gje qe bie ne kundeshitim me ligjin per arshive/protokollin si dhe ne vertetim eshte shenuar se kontrata eshte ne periudhe garancie, pra qe nuk eshte mbyllur perfundimisht sherbimin”.

Mbi pretendimet qe keni per numrin e protokollit jeni te lire te kryeni detyren tuaj si AK konfom ligjit dhe te kerkoni informacione tek Institucioni qe na e ka leshuar vertetimin. Thelbi I leshimit te vertetimit eshte te provoje se shoqeria jone e ka ekzekutuar objektin e kontrates me sukses dhe se eshte e afte te kryeje furnizime te tjera te ketij lloji. Gjithashtu vertetimi I realizmit eshte nje dokument I rregullt ku jane pasqyruar te gjitha te dhenat e kontrates dhe eshte firmosur dhe I vulosur nga institucioni perkates. Sa I takon references qe AK ka bere per “Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 per Arkivat” ne asnje dispozite nuk eshte percaktuar qe nje dokument nuk eshte I vlefshem nese eshte I protokolluar “ekstra”. Cdo AK, mban pergjegjesine e tij lidhur me administrimin e shkresave te tij. Eshte ne pamundesi totale te nje OE, t'i diktoje keto detaje nje AK. Ne DST ju keni shprehur qarte cfare duhet te permbaje nje vertetim: kohen e furnizimit, vleren e realizuar si dhe vertetim realizimi me sukses I kontrates. Te gjitha keto elemente jane te shprehura ne dokumentin ne fjale, I cili eshte firmosur dhe vulosur nga AK. Pra, ky dokument eshte me se I rregullt. Ju sqarojme dhe se zbatimi I kesaj kontrate ka perfunduar me 28.09.2020, gje qe mund te shihni shume qarte ne vertetimin e realizmit. Sipas kushteve te kontrates , OE mban garanci per produktet e dorezuara. Pra, kontrata eshte realizuar me sukses, produktet jane akoma ne garanci. KU qendron problemi ketu ?! Ju keni kerkuar vertetim per realizim kontrate dhe kjo kontrate eshte realizuar me sukses. Me kete logjike qe arsyeton AK, rezulton te perjashtohen kontratat

e realizuara vitin e fundit, pasi ato akoma jane ne periudhe garancie, ne zbatim te ligjit qe I jep te drejte AK te kerkoje nje garanci deri 1 vjecare per produktet e levruara. Kjo eshte teresisht ne kundërshtim me LPP dhe rregullat e Prokurimit Publik, i cili percakton qarte si te vlefshme “KONTRATAT E REALIZUARA” ne tre vitet e fundit. Pra, për sa argumentuam dhe sqaruam më lart, gjykojme se skualifikimi i ofertës së “Infosoft Office” ShPK është i padrejtë dhe i pabazuar ne ligj.

Sa më lart të bindur për ligjshmërinë e kërkesave tona si dhe referuar LPP Nr.162/2020, specifikisht Neni 77, Neni 92, Neni 82 dhe Neni 111 i Rregullave të Prokurimit Publik, kërkojmë nxjerrjen e një riklasifikimi, duke konsideruar ofertën tonë si të rregullt. Bazuar në nenin 111 të LPP po paraqesim këtë ankesë.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit 1015/2, datë 12.05.2022 u publikuan arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes.

II.7. Me shkresën nr. 1569/1 prot., datë 27.05.2022, protokolluar me tonën me nr. 1015/4 prot., datë 01.06.2022, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimes “Infosoft Office”SHPK, në të cilin konstatohet se komisioni i shqyrtimit të ankesës me vendimin e datës 16.05.2022 ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Infosoft Office” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se: *“Per pretendimin e AK mbi mosparaqitjen e dokumentit per te vertetuar se jane paguar taksat; dokumenti i cili verteton se taksat jane paguar eshte ngarkuar ne SPE sipas kerkeses te kryer ne DST ne kriteret e vecanta; Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2.2i. Ky dokument provon qe jane likuiduar detyrimet e taksave vendore te parashikuara sipas Ligjit Nr.1632 date 30.10.2006 Per sistemin e taksave vendore, me ndryshimet perkatese si dhe Vendimit te Keshillit Bashkiak Nr.158, date 26.12.2019 Per sistemin e taksave dhe tarifave vendore ne qytetin e Tiranës. Per me teper pavaresisht se eshte kerkuar vetem per vitin 2021, ne kemi ngarkuar dhe dokumentin per vitin 2022, per te provuar keshtu se shoqeria jone nuk ka detyrime te palikuiduara dhe vepron konform ligjeve dhe rregullave. Pretendimi i AK nuk qendron.”* KPP vëren se,

III.1.2. Në kthimin e përgjigjes në lidhje me këtë pretendim autoritetit kontraktor ka argumentuar se: *“Në lidhje me taksat si tarifë vendore ju sqarojmë se: Komisioni i vleresimit të ofertave është shprehur që Mungojnë në dokumentet që vertetojnë që nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, kërkuar në DST, pika 1 “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes Kualifikimit”, pika 1. Dh ku thuhet që “Operatori Ekonomik nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 7612 të LPP-së dhe nuk është kërkuar në asnjë moment të vertetohet për tarifën vendore në këtë pikë pasi Vërtetim që ka shlyer gjithë detyrimet vendore kërkohej në DST në pikën 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2.2 “Vërtetim që ka shlyer gjithë detyrimet vendore për vitin 2021, ku operatori zhvillon aktivitetin”, Për këtë arsye pretendimi [...]”*

III.1.3. Në rastin konkret nisur nga arsyeja e skualifikimi dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK rezulton, se arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues ka ndodhur për shkak se sipas autoritetit kontraktor mungojnë dokumentet që vërtetojnë se nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore në përmbushje të pikës 1/dh të kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit dhe jo për mospërmbushje të pikës 2.2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” në lidhje me detyrimet mbi taksat vendore siç operatori ekonomik ankimues pretendon. Në këtë kuadër komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues ka ngritur një pretendim, i cili nuk ka qenë arsye për skualifikim nga KVO e autoritetit kontraktor prandaj ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk merret në shqyrtim.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se: *“Mbi kontributet e sigurimeve shoqërore ju sqarojmë se: për pretendimin e AK mbi mosparaqitjen e dokumentit për të vertetuar se janë paguar sigurimet shoqërore perkatësisht pika 1 dh e “Kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”. Pika 1 dh është një nga elementet e formularit të vetedeklarimit. Me ligjin e ri nr. 162/2020 OE nuk ka detyrim ligjor ta paraqesi këtë dokument në fazën e ofertimit, ju sjellim në vëmendje nenin 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.201.....”* KPP vëren se,

III.2.1. Në dokumentet standarde të tenderit kriteret e përgjithshme të kualifikimit pika 1 “dh” autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore ose ndodhet në ndonjë prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

.....

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.”

III.2.2. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- *Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në kriteret e përgjithshme për kualifikim).*

III.2.3. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes në lidhje me këtë pretendim ka argumentuar se: *“Në lidhje me kontributet e sigurime shoqërore si dhe taksat si detyrim fiskal, ju sqarojmë se: Në vertetimin e paraqitur nga OE në SPE me nr.392 prot, datë 12.04.2022 shprehet qartë që OE ka detyrime gjopa në tatimin në Burim në shumën 812500 lekë, detyrim ky i vendosur në vertetimin e lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, Tiranë dhe që ky vertetim që OE ka paraqitur nuk i përmbush kërkesat e dokumenteve të kërkuara ne DST, pretendimet e OE që është në proces ankimimi administrativ nuk vertetohet objekti të këtë lidhje me shumën në fjalë. Për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.”*

III.2.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.2.5. Në nenin 26 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.*

Këto kriterë synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.”.

Ndërsa në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve¹ të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

5. *Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*
6. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. *Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”*

III.2.6. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.7. Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të

² Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

dorëzuar në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Bazuar në materialet e fashikullit të shqyrtimit administrativ vihet re, se autoriteti kontraktor në asnjë koment nuk e ka shfaqur të nevojshme të kryejë verifikime apo të kërkojë sqarime nga operatori ekonomik në lidhje me dokumentacionin provues për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, pasi nëse do të ishim përballë një fakti të tillë është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues në momentin e paraqitjes në SPE të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit i ka përmbushur kriteret e përgjithshme për kualifikim dhe konkretisht pikën 1/dh të tyre në përputhje me legjislacion sektorial në fuqi për prokurimin publik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se: *“Mbi taksën si detyrim fiskal ju sqarojmë se: “Infosoft Office” ShPK me administrator Z. Gëzim Dobi nuk ka detyrime tatimore në Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, mbi Fitimin, Tatim mbi të Ardhurat Personale. AK permend si arsye skualifikimi” se subjekti në fjale rezulton me gjobë dhe vendimi i gjykatës i viti 2019 nuk verteton lidhjen me detyrimin në fjale...”* KPP vëren se,

III.3.1. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik në përmbushje të detyrimit për vërtetimin e pagesave të detyrimeve tatimore operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim nr. 392 prot., datë 12.04.2022 të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve nga ku rezulton se operatori ekonomik ankimues ka detyrime (gjoba) në Tatimin në Burim në shumën x lekë për të cilat ndodhet në proces ankimi administrativ.
- Vendim nr.4488, datë 30.12.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë
- Vërtetim të datës 14.04.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit
- Vendime të KPP nr.651/2017 dhe nr. 321/2020.

III.3.2. Në nenin 76 pika 2/a të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:” 2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;”

III.3.3. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për

pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.3.4. Në nenin 26 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.*

Këto kriteret synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.”.

III.3.5. Nisur nga arsyeja e skualifikimi të operatorit ekonomik ankimues se *“nuk ka paraqitur dokument që verteton se nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore pasi subjekti në fjalë rezultoi me gjobë dhe vendimi i gjykatës i vitit 2019 nuk vërtetoi lidhjen me detyrimin në fjalë”* Komisioni i gjykon të padrejtë vendimin e KVO-së se autoritetit kontraktor, pasi duke qenë se subjekti sipas vërtetimit të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve nr.392 prot., datë 12.04.2022, rezultoi me detyrim tatimor (gjobë) dhe është në proces ankimi nuk jemi në kushtet për skualifikimin e një operatori ekonomik nga procedura e prokurimit në kuptim të nenit 76 pika 2 të *lex specialis* për prokurimin publik i cili parashikon se: *“2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatorit ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur: a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;”*

Akoma më tej ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, në nenin 6 pika 3 parashikon se *“Me detyrim tatimor”* nënkupton *“tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”*. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, për të arritur në vendimmarrje vlerësoi se duhej të kishte parasysh: -jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (shiko Vendimin nr.16, datë 25.07.2008) - në bazë të cilës janë bërë dhe ndryshime në legjislacionin tatimor; - Vendimin Unifikues nr.4, datë 30.05.2011 të Gjykatës së Lartë – i cili shprehet se: *“Me “detyrim tatimor”, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 6/3 nënkupton “tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”*. Dallohet qartësia në ligj, që për t’u marrë në shqyrtim ankimi, detyrimisht duhet që të parapaguhet, sipas aktit administrativ Njoftim-Vlerësimit, detyrimi tatimor, i cili duhet të ketë të përfshirë tatimin dhe kamatëvonesat. Gjobat, megjithëse konsiderohen sipas nenit të cituar, si pjesë e detyrimit tatimor, nuk përfshihen si pjesë e parapagimit të detyrimit, si një kusht i domosdoshëm për të marrë në shqyrtim ankimin administrativ.” Në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për

procedurat tatimore në RSh” (i ndryshuar), neni 107 i të cilit parashikon se: 1. “1. Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që bashkë me ankesën të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor ose të vendosë garanci bankare minimalisht 6 muaj, por jo më pak se afati, sipas të cilit vendimi ka marrë formë të prerë për shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore.2. Shuma e pagueshme ose shumën e vënë si garanci bankare, sipas pikës 1 të këtij neni, përjashton gjokat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar, si dhe kamatëvonesat e llogaritura.3. Ankimi merret në shqyrtim vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, që është objekt i ankimit, ose ka paraqitur dokumentin bankar që vërteton vendosjen e garancisë, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2 të këtij neni.” Ndërsa në Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 të Ministrit të Financave parashikohet se: “Shuma e detyrimit për t’u paguar përfshin vetëm shumën e tatimit dhe interesin, nëse ka, në aktin administrativ që ankimohet, që është i pagueshëm në momentin e ankimit, duke përjashtuar gjokat e përfshira në aktin administrativ objekt-ankimimi”. Bazuar në gjithë sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vendimi i KVO-së së autoritetit kontraktor për skualifikimin e operatori ekonomik ankimues me pretendimin se: “*nuk ka paraqitur dokument që vërteton se nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore pasi subjekti në fjalë rezultoi me gjokë dhe vendimi i gjykatës i vitit 2019 nuk vërteton lidhjen me detyrimin në fjalë*”, kur këto gjoka sipas dokumenteve provuese vërtetohet se janë në proces ankimimi, nuk është në përputhje me frymën e legjislacionit për prokurimin publik. Në balancën mes përpjekjes për të siguruar pagesën e plotë të të gjitha elementeve të detyrimit tatimor, nga njëra anë, dhe mirpërdorimin e fondeve publike – që arrihet përpara së gjithash përmes një pjesëmarrjeje të gjerë e konkurruese të operatorëve ekonomikë, nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në ato raste kur nga operatori pjesëmarrës në procedurën e prokurimit është paguar tatimi përkatës dhe interesi, ndërkohë që gjoka është në proces ankimimi, nuk mund të ngrihet si pretendim dhe të shërbejë si arsye skualifikimi. Sa më sipër, me anë të dokumentacionit të dorëzuar në S.P.E. nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK vërtetohet, se ka shlyer detyrimet tatimore në fuqi. Kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Pra, KPP gjykon, se operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, i përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.6 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se: “*Mungojnë dokumentet që ka kryer shërbime të ngjashme, kerkuar në DST, pika 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2.3.1, në lidhje me shërbime të ngjashme të realizuara, vërtetimi i realizimit me sukses të kontratës nuk ka numer protokollin të rregullt, por është vërtetim i marrë me numer protokollin ekstra, gje që bie në kundërshtim me ligjin për arshivë protokollin si dhe në vërtetim është shënuar se kontrata është në periudhë garancie, pra që nuk është mbyllur përfundimisht shërbimi.*” KPP vëren se:

III.6.1. Në dokumentet standarde të tenderit, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.1 autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.1 OE duhet të ketë kryer shërbime të ngjashme të realizuara gjatë 3 viteve të fundit jo nën 20% të vlerës së objektit që prokurohet, për këtë duhet:

- *Formularë vlerësimi nga AK për cilësinë e kryerjes së furnizimit me materiale kancelarie ku të shënohet , koha e furnizimit, vlera e realizuar si dhe vërtetim realizimi me sukses i kontratës.*
- *Në rast të kryerjes së këtij shërbimi me subjekte private duhet të dorezohen fatura tatimore shitje ku të jenë të shënuar sakte datat, mallrat, sasi të, shumat si dhe emri e nënshkrimi i personit blerës.*

III.6.2. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik ankimes ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

*-Vërtetim realizimi me nr. prot.ext, datë 16.03.2021 të lëshuar nga Albcontrol SHA
- Kontratë nr.281/9 prot., datë 24.08.2020 të lidhur me Albcontrol SHA.*

III.6.3. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes lidhur me këtë pretendim ka argumentuar se:

“Në lidhje me shërbime të ngjashme të realizuara, vërtetimi i realizimit me sukses të kontratës nuk ka nr.protokollin të rregullt pasi është marrë me nr.protokollin ekstra, gjë që bie në kundërshtim me ligjin për arhive-protokollin, si dhe në vërtetim është shënuar se kontrata është në periudhë garancie, pra që nuk ka përfunduar akoma si objekt në momentin e lëshimit të vërtetimit të paraqitur pranë AK nga OE. Për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.”

III.6.4. Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.6.5. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i

ndryshuar, parashikohet se: “ 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.6.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë, se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.6.7. Në rastin konkret nisur nga arsyeja e skualifikimit dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e kontratave të ngjashme të shoqëruara me vërtetimin e realizimit të kontratës në rast se ajo lidhet me subjekte shtetërore ose me fatuarat e blerjes në rastet kur ajo lidhet me subjekte private në thelb, ka të bëjë me garancinë që fiton autoriteti kontraktor, që operatori ekonomik i cili pretendon të fitojë kontraktën publike zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe tekniko-profesionale për realizimin me sukses të kontratës që do të konkludojë nga procedura konkrete e prokurimit. Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron shërbime të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, kërkesë kjo e cila është plotësuar nga ana e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, duke paraqitur në SPE një kontratë të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit dhe të shoqëruar me vërtetimin për realizimin e saj nga institucioni përkatës. Në këtë kuptim, çdo pretendim tjetër i paraqitur nga autoriteti kontraktor si arsye skualifikimi në lidhje me përmbushjen e kriterit të përcaktuar lidhur me paraqitjen e kontratave të ngjashme, del përtej asaj çfarë autoriteti kontraktor ka kërkuar në dokumentet e tenderit dhe qëllimit të cilit i shërben ky kërkim.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-24676-04-11-2022 me objekt “Blerje kancelarie për Bashkinë Fushë-Arrëz”, me fond limit 1,404,780.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 27.04.2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Fushë-Arrëz.
2. Autoriteti të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

